

VENDIM
Nr. 727, datë 2.11.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË
SHESHIN “NËNË TEREZA””, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.27/2014, TË KKR-
SË (FAZA II)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””, miratuar me vendimin nr.27/2014, të KKR-së (faza II).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me një vlerë të përgjithshme 3 233 925 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë, dhe për pasurinë “objekt”, me një vlerë të përgjithshme 5 969 161 (pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 203 086 (nëntë milionë e dyqind e tre mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Kulturës.

6. Pronari i pasurive, për të cilin është bërë shënimi “sipas kartelës së pasurisë”, të likuidohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës.

7. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4 dhe 6, të këtij vendimi.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës në hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN, PËR MARRJEN
NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTTI “NDËRHYRJE TË PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN “NËNË TEREZA””
MIRATUAR ME VENDIM TË KKR NR. 27/2014

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi lekë/m ²		Vlera leke			SHËNIME
				truall	ndërtim	truall	ndërtim	truallit	ndërtesë	Banesë	
1	Ornela Mansaku	8280	2/335	135.0	135.0	23,955.0	44,216.007	3,233,925	5,969,161		sipas kartelës së pasurisë
				135	135.0			3,233,925	5,969,161	-	9,203,086
				TOTALI		Lekë					

